



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno.Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	28.03.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 19/2
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.08/2017 të dt. 27.03.2017 për lëndën Gëzim Paçarizi Nr.04-353-32373 për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 7685-6.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA KOSOVO
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENT PROTECTION
Nr. 121 Prishtinë 27.03.2017
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 08/2017
Datë: 27.03.2017

Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i projektit / kërkesës për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale me Nr. 7685 – 6 me pronar Gëzim Paçarizi – Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në lidhje me kërkesën për shqyrtimin e lëndës – objekti i kërkesës, ndërtim i objektit shtëpi individuale për banim (Lënda Nr.04-353-32373 me dt.30.03.2016), në ngastrën 7685-6, me sipërfaqe oborr 139 m², ndërsa shtëpi 61 m², me sipërfaqe totale të ngastrës 200 m², konstatohet se sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, ngastra kadastrale gjendet në Zonën e IV – të. Lënda së fundmi është shqyrtuar në takimin e datës 24.11.2016, kur edhe komisioni ka shqyrtuar Projektin Ideor të ndryshuar, dhe ka vërejtur që mungon incizimi gjeodezik për pasojë është kthyer lënda për plotësim të plotë të dokumentacionit.

Lënda e sjellë në plotësim përmban Projektin Ideor, kopjen e planit, incizimin gjeodezik dhe një shkresë përcjellëse nga pala. Pas analizimit të të dhënave nga projekti dhe dokumentet e bashkangjitura, Komisioni vlerëson se Projektin Ideor është në harmoni të plotë me kriteret e përcaktuara me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, Zona IV.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, përfundimisht ka rekomanduar aprovimin Projektin Ideor për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale 7685 – 6 me pronar Gëzim Paçarizi, në bazë të të cilit rekomandim është vendosur si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kabineti të Ministrisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

